

FJALA E DEPUTETIT DAMIAN GJIKNURI

E ENJTE 10 MARS 2022

Mirëdita të gjithëve!

Në fakt, do të doja t'ia kurseja këtë fjalë publikut sepse, sa u takon akuzave të ngritura qoftë ndaj qeverisë, qoftë ndaj personit tim, patëm mundësinë t'i çmontojmë në mënyrë të qetë para komisionit hetimor, një komision që realisht do ta quaja qesharak, pasi përdora me ironi edhe një shprehje, të cilën dua t'ua kujtoj kolegëve, që në fund prodhoi këtë fletë-rrufe politike. Pamë se si kolegët u transformuan në prokurorë, njerëz që janë në konflikt interesi me politikën e tyre. Sepse, në fund të fundit, çfarë janë ata? Ata janë njerëz që duan të sulmojnë maxhorancën. Ju përmenda edhe Eksperimentin e Stanfordit, ku u morën studentë nga e njëjta klasë, disa prej të cilëve u bënë roje burgu, ndërsa disa u bënë të burgosur, dhe se si pësuan një transformim psikologjik. Pikërisht këtë pashë tek të gjithë personazhet e Partisë Demokratike në atë komision, që u transformuan në prokurorë, madje duke ua kaluar prokurorëve me akuzat e tyre qesharake ndaj qeverisë, aq sa çmontuan edhe vetë kauzën e tyre, që besonin dhe mendonin se e kishin ngritur mirë. Në fakt, unë do të flas në dy plane.

Së pari do të flas në lidhje me disa lajthitje, që edhe te ky raport që kanë nxjerrë tregohet qartë se e kanë bërë copa-copa njerëz të ndryshëm dhe kanë nxituar të prodhojnë një trakt politik, sepse vetëm trakt politik është ai. Nga ana tjetër, dua të flas politikisht në lidhje me atë çka është bërë me këto vepra, të cilat pavarësisht akuzave që janë ngritur apo edhe episodeve që meritojnë hetim, si shumë kontrata publike që mund të kenë akuzat, nuk mund të mohohet vlera e tyre. E para, në lidhje me personin tim, unë e kam sqaruar fare mirë në komision, por po e them edhe një herë: emri im është futur atje qëllimisht, me porosi të kreut të Partisë Demokratike, që të njolloset sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste, të njolloset Damian Gjikhuri, megjithëse roli im në ato procedura është minimal dhe nuk ka asnjë lidhje. Po të lexosh traktin politik, që kanë prodhuar, ku transformohen edhe fjalët që vijnë nga shkresat, vetëm e vetëm që të asociohet dikush me një fajësi, kupton se gjithçka bëhet me qëllim dhe meriton të quhet shpifje. Thuhet se zoti Gjikhuri e ka quajtur procedurën nga ana e Autoritetit Kontraktor të drejtë, kur shkresa e thotë fare qartë: është e drejtë e Autoritetit Kontraktor, është diskrecion i Autoritetit Kontraktor të zhvillojë procedurën në përputhje me ligjin.

Kjo është qeveria, këto janë organet ku konsultohen, japin mendim për fushën e tyre, por patjetër që diskrecionin ia lënë atij që inicion procedurën. E dyta: si mund të ngrihen akuzat të tilla? Ku i keni parë ju? Vetëm mendja juaj perverse politike mund të thotë: "grup i strukturuar kriminal". A keni parë ju organizatë shtetërore grup të strukturuar kriminal? Organet shtetërore janë ngritur për të zbatuar ligjin. Edhe kur ka shkelje për shpërdorim detyre, ato hetohen, por nuk mund të kenë qëllime kriminale. Çfarë doni të bëni ju? Tani sa më shumë që kalojnë ditët, dita juaj bëhet shumë e largët për pushtetin, fatkeqësisht për ju e për ata që ju mbështesin, por si mund të mendoni se një shtet, një qeveri qenka strukturë e organizuar e krimit? Si mund t'ju shkojë ndër mend? Si do të mendoni të hyni në ato zyra? E pra, ky është absurditeti i këtij trakti politik, të prodhuar nga ai komision pervers, që unë e thashë, është pjesë e një eksperimenti psiko-social të njerëzve që mendojnë se duke dalë në televizor e duke bërë

prokurorin, mund të fitojnë vota dhe pikë. Në fakt, jo më kot ai komision u ngrit si sfond i zhvillimeve të tjera politike nga Partia Demokratike. Se në fillim u nis me vrull, pastaj u la. Në momentin kur e detyruan të votojë një ndryshim kushtetues, u duk se diçka mori; e filluan me vrull për dhjetë ditë, se përkonte edhe me fushatën elektorale të 6 marsit, gjoja se çoç do të nxirrnin, pasi u zgërlaqën. E pashë kryetarin e opozitës, atë që gjithmonë bërtet, që kruante zërin si i zgërlaqur fare, mezi i dilte fjala. Mbaruam punë tashti, tha, e tashti do të hetojë prokuroria. Pse? Normale, sepse sfondi që ngriti komisionin dështoi; ai kundërshtari i tij, antibrava, punoi në terren, i mori votat, ndërsa ky kujtonte se me syleshët e komisionit do të bindte njerëzit të votonin për të. Pra, ky ishte edhe dështimi tjetër i këtij komisioni. Dilni këtu e flisni absurditete. Si i mendoni dhe i shkruani njëherë! Nuk e di kush jua thotë: “Është dhënë një koncesion i fshehtë nga Gjiknuri për njëzet e pesë vjet.” Ndërkohë, aty është një shkresë, një autorizim i qartë, me bazë ligjore. Pse nuk e analizoni shkresën ju?

Pse nuk morët ndonjë ekspert të komisioneve për ta pyetur nga ana ligjore: o zotëri, se kemi hetime në lidhje me këtë koncesionin e fshehtë, ky thotë: baza ligjore, neni 49, pika 1, VKM 822 e të tjera e të tjera. Atëherë si qenka koncesion i fshehtë ky, kur është një akt me bazë ligjore të qartë dhe me detyrim ministri, bazuar në kontratë? Ndërsa vendimin e qeverisë e shpjegoi mirë anëtarja jonë e komisionit në raportin që mbajti. Ju me të njëjtin qëllim, për të shpifur e për të bërë pis njerëzit këtu, dilni dhe flisni broçkulla: “koncesion i fshehtë”, ndërkohë që të gjitha të drejtat janë të përcaktuara në kontratë. Prapë është shpërdorim detyre nga ana juaj, në qoftë se do të merreni si grup i strukturuar kriminal parlamentar, për të krijuar fakte penale të paqena. Thoni: “akoma vazhdon koncesioni i fshehtë”, kur nga gjithë dokumentacioni i paraqitur, që e citoni vetë, ai koncesion ka përfunduar dhe kontraktorët në fjalë e kanë dorëzuar me letra, pavarësisht se është nën sekuestron e prokurorisë për shkak të hetimit. Pse nuk e thoni këtë fjalë ju? Pse gënjeni haptas, ashtu siç morët përsipër të mashtroni me udhëtime? Po pse, kush jeni ju, do të bëni kombinimet e njerëzve se si udhëtojnë në transport publik dhe do të nxirrni konkluzione? Po sa herë mund të ketë fluturuar Basha me Zoton, që ka dalë publikisht? Çfarë do të them unë, që ka lidhje? Apo unë me Lulzim Bashën, që më ka rastisur me dhjetëra herë të jem në një avion?

Çfarë do të nxirrni ju, do të nxirrni asocime, se përse ndodhesh në transport publik? Nuk di, por mund të ketë ndodhur edhe në kohën e komunizmit, që të hipte një i deklasuar me një komunist në të njëjtin autobus dhe t’i bënin fajtorë. Vetëm ju mendoni kështu, vetëm mendjet tuaja mund të nxjerrin konkluzione të tilla. Këtu keni përfunduar ju, më vjen keq. Prandaj thashë se ajo farsë e bërë këtu dhe ai trakt nuk nxorën asgjë, përveçse provuan falsitetin e të gjitha akuzave dhe dështoi edhe sfondi në të cilin u zhvillua. Se e thashë: komisioni hetimor u zhvillua për t’i dhënë oksigjen një partie, që fatkeqësisht po shkërmoqet e po shkërmoqet përditë, dhe nuk ju vlejti as për fushatën e radhës. Në raport keni prapë lajthitje të tjera, që më bëjnë përshtypje, se vetëm absurditete të tilla nxirrni në pah, me aq pak gjëra sa pashë. Pika 266 thotë: “Në tetor të 2016-ës Ministri Gjiknuri, si autoritet kontraktor përgjegjës, nuk nxori grupin për njësinë e zbatimit të projektit.” O zotërinj, po vetë e keni thënë se në tetor të vitit 2016-ës kontratën e ka bërë dikush tjetër. Pas një viti, thonë, e nxori ministri Gjiknuri.

Aq të pakujdesshëm jeni në ato që shkruani, sa duket sikur i ka marrë dikush copy paste, njerëz të nxitur, njerëz të ndryshëm: ti do të bësh këtë, ti do të thuash këtë; siç dilte ajo zonja në komision, apo çonte dikush një sms: thuaj këtë, derisa dikush përfundoi te lejet minerare. Të gjitha këto tregojnë falsitetin e

punës së këtij komisioni. Prandaj, shikojeni mirë këtë raport para se ta çoni, që të paktën të korrigjoni ca gjëra, meqenëse e lexova tashti shpejt, por ajo që thatë këtu nuk i fsheh ato që janë bërë. Qeveria shqiptare, pavarësisht ndonjë pretendimi që mund të ketë, sepse çdo procedurë mund të ketë akuza, sikundër çdo vepër publike ka pasur akuza për njerëzit që e kanë bërë, për qeveritë që e kanë nisur. Mos harroni akuzat që keni pasur në kurriz me “Rrugën e Kombit” e të tjera e të tjera, të cilat fatkeqësisht nuk u hetuan, sepse ai zotëria që dikur fliste me zë të lartë, ndonëse sot zëri i kishte kaluar në belbëzim, iu shmang hetimit, ndërsa të gjithë po përballen me drejtësinë. Kemi vajtur edhe për akuzat që keni ngritur personalisht ndaj meje, se këto shifrat e mëdha i keni qejf ju, 600 milionë euro, që i paskështa vjedhur me CEZ-in; vajta, u përballa me drejtësinë dhe u bë çmontimi i të gjitha akuzave tuaja, që i ngrini me këto shifrat 600 milionë, 450 milionë, se i keni qejf shifrat e mëdha. Harroni se shifrat e mëdha janë të pabesueshme. Fokusohuni tek të voglat.

Nga ana tjetër, dua të them edhe të fundit, që pavarësisht kritikave apo hijeve që mund të kenë dalë për ndonjë veprim të dyshuar korruptiv, asnjë nuk e mohon se këto vepra po japin rezultatin e tyre. Sot në Elbasan kemi një incenerator që funksionon, që ka zgjidhur një problem mjedisor. Së shpejti do të kemi edhe një në Fier. A meritojmë të hetohemi? Të vazhdojë të hetojë prokuroria në lidhje me ndonjë procedurë që nuk është bërë mirë, por ju nuk mund t’u thoni shqiptarëve që u vodhën 400 e ca milionë dhe se shqiptarët s’kanë parë asnjë të mirë publike. Ajo çfarë ka bërë qeveria shqiptare ka qenë e bazuar – e kam thënë në një interpelancë, edhe kur ka qenë zonja Tabaku – në strategjinë e miratuar nga Sali Berisha, hierarkia e trajtimit të mbetjeve dhe ne vazhduam një strategji të filluar nga qeveria tjetër. Kështu që, komisioni hetimor që prodhoi këtë trakt politik, i shërbeu me turp kauzës së atyre që e nisën, sepse u katandisët me vota sa një këshilltar bashkie në Vorë. Ky është realiteti që do të prodhojnë komisionet tuaja. Fokusohuni në atë që ju kam thënë: punoni me njerëzit, mos u merrni me deklarata dhe komisione hetimore, se do të katandiseni shumë më keq. Falemnderit!